

ANILA DENAJ

Datëlindja: 18.09.1973

Vendlindja: Tiranë

Email: Anila.Denaj@parlament.al



Jetëshkrimi:

Anila Denaj ka lindur në Tiranë, më 18 shtator 1973. Znj. Denaj është diplomuar për Menaxhim Financiar dhe Bankar në vitin 1995 në Universitetin e Tiranës dhe ka më shumë se 22 vjet përvojë pune.

Në shtator 2018, znj. Denaj u emërua Drejtore e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor (FSDKSH) në Shqipëri. Më herët, znj. Denaj ka qenë anëtare e Bordit të Këshillit Administrativ të FSDKSH-së, anëtare e Bordit të Fondit Shqiptar të Sigurimeve Shoqërore dhe anëtare e Bordit Mbikëqyrës së Kompanisë së Sigurimeve INSIG SH.A. Për një periudhë tre vjeçare, znj. Denaj ka qenë Anëtare e Bordit të Autoritetit të Komunikimit Elektronik dhe Postar në Shqipëri (A.K.E.P). Përgjatë periudhës tetor 2013 – janar 2015 ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, me fokus kryesor mbikëqyrjen e operacioneve në Departamentin e Financave, Legjislacionit dhe Menaxhimit të Pronës Shtetërore, në menaxhimin e teknologjisë së informacionit, Departamentit të Administratës dhe të Burimeve Njerëzore.

Znj. Denaj ka punuar për 12 vjet në ProCredit Holding Gmbh/ IPC Consulting Gmbh, duke mbajtur pozicione të ndryshme drejtuese në bankat e Grupit ProCredit në: Salvador, Bolivi,

Ekuador, Rumani dhe Mozambik. Eksperiencën e saj në këtë fushë e ka nisur në bankën FEFAD, më vonë të quajtur ProCredit. Në këtë aktivitet, ajo ka mbajtur pozicionin Zëvendësdrejtore e Përgjithshme e bankës. Znj. Denaj ka bashkëpunuar me Shkollën e Administratës Publike (ASPA) që nga viti 2014, si lektore me kohë të pjesshme në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Nga Viti 2019 deri në 2021 ka qenë Ministre e Financave dhe Ekonomisë. Ajo është certifikuar dhe trajnuar në menaxhim, drejtim, dhe financat bankare si dhe nga Komisioni i BE-së si Lektore për Programin e Akademisë së Liderit.